



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM

PËR ÇELJEN E GARËS PËR LËSHIMIN E 2 (DY) LICENCAVE TË SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv” miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 2, datë 16.01.2020, si dhe vendimit nr. 82, datë 15.07.2022 të AMA-s “Për çeljen e garës për lëshimin e 2 (dy) licencave të shërbimit të programit audioviziv”, në muajin tetor 2022 do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së aplikimeve për dhënien e licencave të shërbimit të programit audioviziv, si më poshtë:

1. Lëshimin e 1 (një) licence rajonale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Fier (allotmentet Tiranë, Elbasan dhe Fier).
2. Lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv tematik informativ në qarqet Tiranë dhe Durrës (allotmenti Tiranë).

Subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë shërbimi programi audioviziv janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, Tiranë, brenda datës 10 tetor 2022.

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidaturave, që përfshin:

- Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv” miratuar me vendimin e AMA-s nr. 2, datë 16.01.2020, ku përfshihen kerkesat ligjore, ekonomike, teknike, programore etj,
- Pagesat për licencë;

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA pas kryerjes së pagesës për blerje dokumentacioni në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

Aplikimet do të hapen më datë 10 tetor 2022, ora 12:00, në mjediset e AMA-s ku aplikuesit apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.